



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK
V E N D I M

Nr. 98 Datë 25-09-2025

**PËR MIRATIMIN E SHITESËS SË PLANIT TË BUXHETIT PREJ 400.000 LEKË PËR
“FESTIVALI NDERKOMBETAR I KOMEDISE , KOKOFEST” (RIKTHIM) SI DHE
REALIZIMIN E PROJEKTIT “EKSPOZITË ETNOGRAFIKE”**

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi mori në analizë materialin e paraqitur nga Qendra e Artit dhe Kulturës, bazuar në ligjin nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 68 datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin 115/2024 datë 03.12.2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, udhëzimin plotësues nr. 2 datë 24.01.2025 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025”, udhëzimin nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, VKB nr. 176 datë 26.12.2024 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor të vitit 2025 dhe PBA 2025-2027 të Bashkisë Korçë”, si dhe urdhërin nr.11 datë 14.01.2025 “Për detajimin e shpenzimeve korrente për vitin 2025 të Bashkisë dhe Institucioneve të Varësisë sipas programeve dhe produkteve”, i ndryshuar, mbështetur në kompetencat që ka, si dhe mbas diskutimeve dhe propozimeve të këshilltarëve:

VENDOSI

1. Të miratojë shtesën e planit të buxhetit prej 400,000 lekë për “Festivalin Nderkombetar të Komedise , Kokofest” (rikthim) si dhe realizimin e projektit “Ekspozitë Etnografike”, (financim nga Këshilli i Qarkut).
2. Ky financim do të përdoret për shpenzime “honorare”, si më poshtë dhe me këtë strukturë buxhetore:

SHTOHET	00	Prog.AF122	05	Prod V823AAB	Art. 6020000	+250.000 lekë
SHTOHET	00	Prog.AF122	05	Prod V823AAC	Art. 6020000	+150.000 lekë

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MFK si dhe Qendra e Artit dhe Kulturës.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI



Miratuar me 25 vota

Vota Pro 25

Vota Kundër 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur më datë 25-09-2025

KRYETAR

Ana Verushi





REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI I QARKUT KORÇE

Nr. 769/i Prot.
Korçë, më 16 .09.2025



Nr. 9410 Prot
Korçë, më 16.09.2025

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

E lidhur sot më datë, 16 .09.2025 midis palëve:

KËSHILLIT TË QARKUT KORÇË, përfaqësuar nga Kryetari Z.Erjon Nexhipi.

Dhe

BASHKIA KORÇË përfaqësuar nga Kryetari Z.Sotiraq Filo.

Duke shprehur reciprokisht vullnetin për bashkëpunim midis tyre, mbështetur në parimet e bashkëpunimit, konform legjislacionit në fuqi, palët bien dakord për sa më poshtë vijon:

Neni 1

Qëllimi i Marrëveshjes

Kjo marrëveshje lidhet me qëllim organizimin e dy aktiviteteve “**FESTIVALI NDËRKOMBËTAR I KOMEDISË, KOKOFEST**” dhe “**EKSPOZITA ETNOGRAFIKE**”.

Neni 2

Objekti i Marrëveshjes

Objekt i kësaj marrëveshje është financimi i dy aktiviteteve “**FESTIVALI NDËRKOMBËTAR I KOMEDISË, KOKOFEST**” në vlerën prej 150,000 (njëqind e pesëdhjetë mijë lekë) dhe “**EKSPOZITA ETNOGRAFIKE**” në vlerën prej 250,000 (dyqind e pesëdhjetë mijë lekë) duke financuar në vlerën totale prej 400,000 (katërqind mijë lekë) nga Këshilli i Qarkut Korçë, sipas kërkesës paraprake shoqëruar me preventivin e kryer nga nga Qendra e Artit dhe Kulturës, Bashkia Korçë.

Neni 3

Baza Ligjore

Kjo marrëveshje bazohet në dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”i ndryshuar, ligjit Nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, ligjit “Për buxhetin e vitit 2025”, Udhëzimin nr.9 datë 20.07.2018 “Për procedurat

standarte të zbatimit të buxhetit”, Vendimin e Këshillit të Qarkut nr.51 datë 23.12.2024 “Mbi miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut Korçë për vitin 2025”.

Neni 4 Të drejtat dhe Detyrimet e Palëve

Me nënshkrimin e kësaj marrëveshje palët marrin përsipër këto të drejta dhe detyrime:

1. Këshilli i Qarkut Korçë detyrohet të japë kontributin e tij financiar për projektin **“FESTIVALI NDËRKOMBËTAR I KOMEDISË, KOKOFEST”** në shumën prej 150,000 lekë, duke ja kaluar këtë vlerë Qendrës së Artit dhe Kulturës, Bashkia Korçë, për të mbuluar shpenzimet për zërin honorar (aktorë, regjizorë dhe të tjerë krijues të shfaqeve) dhe **EKSPONATA ETNOGRAFIKE** në shumën prej 250,000 lekë, duke ja kaluar këtë vlerë Bashkisë Korçë për mbulimin e shpenzimeve sipas zërit të preventivit (kostumograf dhe instrumentist popullor).
2. Bashkia Korçë (Qendra E Artit Dhe Kulturës) nga ana tjetër detyrohet që në kuadër të projektit të krijojë të gjitha kushtet e nevojshme në mënyrë që të realizohet qëllimi i aktiviteteve.
3. Bashkia Korçë (Qendra E Artit Dhe Kulturës) detyrohet të promovojë Këshillin e Qarkut Korçë si një ndër financuesit e këtyre aktiviteteve.
4. Bashkia Korçë (Qendra E Artit Dhe Kulturës) detyrohet të përdorë në mënyrë sa më efektive fondin e ofruar nga ana e Këshillit të Qarkut Korçë.
5. Bashkia Korçë (Qendra E Artit Dhe Kulturës) do të mbikqyrë dhe ndjekë të gjithë organizimin, si dhe detyrohet që shumën e financuar nga Këshilli i Qarkut Korçë ta përdorë vetëm për realizimin e aktiviteteve **“FESTIVALI NDËRKOMBËTAR I KOMEDISË, KOKOFEST”** dhe **“EKSPONATA ETNOGRAFIKE”**.

Neni 5 Afati dhe Kohëzgjatja

Kjo marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj prej palëve. Marrëveshja do të jetë e vlefshme deri në përfundim të projektit dhe kohëzgjatjes së parashikuar për zbatimin e tij.

Neni 6 Dispozita të Përgjithshme

Cdo ndryshim apo shtesë në këtë marrëveshje do të jetë e vlefshme vetëm nëse bëhet me shkrim dhe firmoset nga të dyja palët.

Palët angazhohen të zgjidhin me mirëkuptim cdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga zbatimi i kësaj marrëveshje.

**PËR
KËSHILLI I QARKUT KORÇË
KRYETARI**

Erjon Nexhipi



**PËR
BASHKIA KORÇË
KRYETARI**

Sotirag Filo



FATURE PER ARKETIM

Numer 15
Date 18.09.2025

Me anë të kësaj fature kërkohet që Banka e Nivelit të Dyte të pranojë nga kliente (persona / persona fizik / persona juridik) arkëtime, për llogari të institucionit tone, me emertime, kode, numer identifikimi dhe shuma si me poshte:

Emri i Institucionit përfitues Oendra e Artit dhe Kultures
Kodi i Institucionit përfitues 2122001
Kodi i Deges se Thesarit ku vepron 1515
Emri i paguesit (person / person fizik / person juridik) KESHILLI I QARKUT KORCE
Numri i Identifikimit te Paguesit K54105077S

ID e Detyrimit	Pershkrimi i te ardhurave		Shuma qe Arketohet (Leke)
	Emertimi	Kodi i Llogarise Ekonomike	
	Transferte K.Q.Korce per honorare	7200102	
1.	Projekti Festivali I Komedise KoKoFest		150000
2.	Projekti Ekspozite Etnografike		250000
	TOTALI		400000

Perfaqesuesi i Institucionit

ZAMIRA BEQIRAJ (KITA)

(Emer, Mbiemer, Nenshkrim)



KLIENTI

Gjyfar Meksi

(Emer, Mbiemer, Nenshkrim)

